 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

-
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. Xhup 3/1



Xhup dimeror me dukshmeri te larte (tre pjese ne nje, secila pjese te disponoje dukshmerine e larte): pjesa e sipërme te mos depertoje shiun dhe eren, te siguroje mbrojtje te gjithanshme ndaj kushteve te motit. , peshe 190gr/m2, me 4 xhepa te gjere te perparme me palosje, ku nje xhep i vogel, unazë mbajtëse per karte pune ne pjesen e jashtme, te kete mbyllje me dopio zinxhir, 100% poliester poliuretano, astar i brendshem 100% poliester120gr/m2 me imbotiture; kapuc i levizshem i cili mund te pershtatet lehtesisht dhe te kycet te kete mundesi pershtatjeje;pjesa e dyte te jete me mende te levizshme, pesha 120gr/m2, xhep ne kraharor i mbyllur me zinxhir, te jaka dhe kycet te kete elasticitet, dy xhepa të përparmë me zinxhir, unazë mbajtëse per karte pune, kapuç te rregullueshem e te levizshem, copa e jashtme 100% poliester poliuretano, astar i

brendshem 100% najlon me imbotiture. Xhupi 3-1nga pjesa e gjoksit dhe shpines e siper duhet te jete ngjyre e verdhe floreshente dhe pjesa e poshtme jeshile ne te erret.

- Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve te motit. Sipas normative SSH/ EN 342; SSH /EN ISO 20471 klasi 2. SSH/ EN 343 klasi 3,SSH/ISO 13688.ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit.

2. Cizme llastiku



Çizme gome me ngjyre **blu ose jeshile** me përbërje 100% polivinil klorid (PVC) me një shtresë tekstili push në anën e brendshme, gjatësia e çizmes deri në kupën e gjurit ,e padepërtueshme nga vaji, me shollë me lule. Material i sholles sitentik i patentuar. Lartesia e cizmes duhet te 33(ne varesi te mases). Lartesia e sholles perpara 1.6 cm dhe ne thember 3 cm. Te jene te prodhuar me PVC. Ti rezistojne ndryshimit te temperatures se ambientit te punes. Te jene te pershtatshme per te punuar ne ambiente me prezence te vajrave lubrifikante, karburanteve, etj. Ngjyra e çizmeve te jete blu ose jeshile Cilesia e larte. Prodhimi i çizmeve te jete bere jo me pare se tre muaj nga koha e levrimit.

- Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH/EN ISO 20347:2012 ose Ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.

3. Këpuce sigurie



Këpuce te mbrojtjes ne pune, forme atlete pa qafe, me pore steelite S3 me linje speciale ajrosje sipas standardit SSH EN ISO 20345 S3Rezistente ndaj vajrave dhe hidrokarbureve. Rezistente

ndaj rreshqitjeve. E veshur me material kunder goditjeve 200J teknologjia PU dendesi e dyfishte, antistatike dhe anatomike poliuretani i bute i mbuluar me pelhure absorbuese dhe me ajrosje me 3 shtresa per transferimin e lageshtise ne pjesen e jashtme dhe tharje te shpejte . Perdorimi te jete i thjeshte dhe komba te ndjehet komode gjate perdorimit duke ruajtur anen shendetsore te perdoruesit. Gjate perdorimit te jete rezistent ndaj djersitjes te mbushura me material per rehati te kockave dhe kyceve te kembes. Mbyllja me lidhese. Lekure bualli ujiduruese.

- Certifikim CE
 - Mbrojtesja e gishtave kompositë për një mbrojte maksimale
 - Shollë e mesme anti-shpim kompositë me shtresë të butë PU
 - Membranë 100% ujëdaluese
 - Shollë anti-rreshkitje (SRC) për të parandaluar rrëshkitjen në qeramike dhe celik.
 - Shollë rezistente ndaj vajrave
 - Shuall me densitet të dyfishtë
 - Përshatje e gjerë
 - Peshë e lehtë
 - Rrjete ajrosese 3D
 - Shtrese mbrojtëse TPU te gishtat për rezistencë më të lartë
 - Lekurë e plotë me trashësi 1.8ml
 - Ngjyra/Fit/Size gri e errët/zeze
-
- Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH/ EN ISO 20345 S3, ose Ekuivalente, **CERTIFIKIMI**
 - Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
 - Te stampuara me logon e institucionit.

4. Kominoshe dimri



Uniforma e punës dyngjyreshe ngjyrë e verdhe floureshente (HV)dhe jeshile e erret me shtresa, materiali të jetë 100% poliesterpesha 190gr/m2 veshur me Dopje PU antinjolle. Me veshje te ngrohte dhe higjenike nga brenda ne pjesen e belit dhe poshte material poliester 60g . Në pjesën e shpinës veshja e punës te jetee përbërë me rripa, e cila ndihmon përdoruesin të përkulet lehtësisht pa ushqetësuar. Me zinxhir plastik. Me 1 xhep në pjesën e kraharorit, 2 xhepa anësore, 2 xhepa nëpjesën e mbrapme si dhe 1 xhep ne pjesen e anes kofshes majte me kapak. Me 2 shirita fosforeshente 5 cm ne pjesen e poshte gjurit. E gjithë pjesa e bustit deri te gjuri duhet ngjyre e jeshile erret, ndersa pjesa poshte verdhe floreshente Ne pjesen e parmeduhet te kete logon e ndermarjes.

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c\ngjyrosja
 - Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
 - 6 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe
 - Xhep telefoni
 - Pjesa mbrapa me llastik
 - Te gjithë tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda
-
- Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve te motit. Sipas normative; SSH EN ISO 20471 klasi 2. SSH/ EN 343 klasi 3:2 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
 - Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
 - Te stampuara me logon e institucionit.

5. Kominoshe vere



Kominoshe e punes me rripa e përbere nga material 65% Poliester dhe 35% Pambuk, pesha 245gr/m2. Ngjyra jeshile e erret pjesa e bustit deri te gjuri dhe e verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, te jete e ngrohte, higjenikisht shume e paster .

- Pelhure shume rezistente me mbrojtje ekselente nga c'ngjyrosja
 - Pelhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV
 - 6 xhepa per hapsire mbajtese me te madhe
 - Xhep telefoni
 - Pjesa mbrapa me llastik
 - Te gjitha tegelat me qepje te forte dhe me suzator nga brenda
 - Mbrojtese zinxhiri
 - Pelhure kryesore: - 65% Poliester, 35% Pambuk 245gr/m2
-
- Veshje mbrojtëse. Sipas normative; SSH /EN ISO 20471 klasi 2 ose ekuivalente, **CERTIFIKIMI**
 - Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
 - Te stampuara me logon e institucionit.

6. Pantallona+XHAKETE



Pantallona me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester, pesha 245gr/m2,Ngjyre jeshile e erret pjesa deri te gjuridhe verdhe floreshente pjesa poshte gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llasik me mundesi pershtatjeje, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

Xhaketa me dukshmeri te larte, 35% pambuk 65% polyester, pesha 245gr/m2. Ngjyre jeshile e erret pjesa e gjoksit shpines dhe e verdhe floreshente pjesa poshte, 2 xhepa perpara pllake me kapak dhe 2 xhepa siper me kapak te gjere dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

- Veshje mbrojtëse. Sipas normative; SSH /EN ISO 20471 klasi 2 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit.

7. Jelek fosforeshent



Jelek material polyester, veshje pune fosforeshente me dukshmeri te larte, rezistente ndaj ujit dhe temperaturave te ulta, praktike profesionale me 2 shirita gri fosforeshente,.

- Sipas normative; SSH/ EN 340 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit.

8. Doreza sigurie



Mbështjellje polietileni me performancë të lartë. Përforcimi TPR(Thermo Plastic Rubber) në shpinë dhe në majë të gishtave. Materiali kryesor për dorezat e mbrojtjes nga goditja eshte TPR Dokumentat Standarde të Tenderit

(Gome Plastike Termike). Elasticiteti I gomës e bën atë zgjedhjen ideale për sigurimin e mbrojtjes së dorës, ndërsa gjithashtu ofron fleksibilitet të plotë dhe lirshmeri të lëvizjes.

Me veshje nitrili në pëllëmbë dhe në majë të gishtave. Përforcimi i brendshëm i stampuar në pëllëmbë. E veshur me nje shtrese akrilik nga brenda. Fije Kevlar në të gjitha shtresat.

- 4: Rezistenca ndaj konsumimit (nga 1 në 4)
- X: Rezistenca ndaj prerjes (nga 1 në 5)
- 4: Rezistenca ndaj grisjes (nga 1 në 4)
- 4: Rezistenca ndaj shpimit (1 deri në 4)
- D: Rezistenca ndaj prerjes nga objekte të mprehta (TDM EN ISO 13997) (nga A në F)
- P: Mbrojtja ndaj ndikimit në zonën metakarpale (P) (EN13594: 2002 6.8.2)
- EN511: 2006 Doreza mbrojtëse kundër të ftohtit (X = provë e përcaktuar)
- 1: Rezistenca ndaj të ftohtit konvektiv (nga 1 në 4)

-
- 3: Rezistenca ndaj të ftohtit (nga 1 në 4)
 - X: i papërshkueshëm nga uji (0 ose 1)
 - Sipas normative; SSH /EN420: 2003 + A1: 2009 Kërkesa të përgjithshme SSH /EN388: 2016 Doreza mbrojtëse ndaj rreziqeve mekanike (Nivelet e marra në pëllëmbë) ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
 - Te cilat perputhen me Rregulloren e BE 2016/425, me kërkesat e saj dhe me standardet e harmonizuara si dhe Rregulloren (BE) 2016/425
 - Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.

9. Doreza pune



Doreza pune per grumbulluesit e mbeturinave me perberje 35% pambuk+35% poliester +30% poliretan Trashesi 0.6-0.8 mm Qendrueshmeri e ngjyres Nota 4; masa 300 gr/m2. Pjesa e jashtme e pellembes se dores dhe e gishterinjve te jete e gomuar, pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme beze pambuku. Te kene gjatesi deri te kyçi me gjeresi 6 cm me perberje pambuk i thurur elastik.

- Sipas normative; SSH EN 420. SSH /EN 388. 2003ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.

10. Pelerine shiu



Pelerine shiu me shirita reflektive duke përdorur pëlhurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht i papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të sigurt, si dhe unaza dhe carje shpinën e pasme për të shtuar ajrosjen.

- Pëlhurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluar për të ndaluar penetrimin e ujit
- Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe
- Shirit reflektues për më shumë dukshmëri
- Hapje me zinxhire para
- 2 xhepa për hapsirë të sigurtë
- Kapuç që paloset nën jakë
- Mëngë elastike nga Brenda
- Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati
- Sipërfaqja e pëlhurës është ekstremisht ujë resistuese, duke e shpërndarë ujin nga sipërfaqja e pëlhurës.
- Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngën e majtë.
- Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g
- Ngjyra/Fit/Size blu e errët/ jeshile erret Nr. S - 3XL
- Sipas normative; SSH/ EN ISO 343:2019 CLASS 3.1 ose ekuivalente, CERTIFIKIMI
- Etiketa e firmes prodhuese të jete të trapezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit, për udhëzimin e përdorimit.
- Të stampuara me logon e institucionit

11. Kapele



Kapele ngjyra e Jeshile , masa 220 gr/m², trashesia 0.5mm, qendrueshmeria e ngjyres Nota 5
thurja sarzh diagonal 2/1, 35% pambuk 65% polyester ne pjesen ballore te jete e stampuar logo

- Te stampuara me logon e institucionit

Ne te gjitha Veshjet ne pjesen e kurrizit do te stampohet Logo e Ndermarrjes si meposhte:



BASHKIA DURRES

NSHK

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT RROBA PUNE2024

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Xhup 3/1	Cope	110
2	Çizma Llastiku	Cope	100
3	Kepuce sigurie	Pale	300
4	Kominoshe dimri	cope	150
5	Kominoshe vere	cope	100
6	Pantallona+Xhaket	Pale	240
7	Jelek fosforeshent	Cope	340
8	Doreza sigurie	Cope	700
9	Doreza pune	Cope	1500
10	Pelerine shiu	Cope	290
11	Kapele verore	Cope	250

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lehtësimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.**
- **Malli do të dorëzohet në prani të komisionit të marrjes në dorëzim në Magazinën e NSHK Durrës, lagja 4, rruga Egnatia.**
- **Furnizimi do të bëhet nga nënshkrimi i kontratës deri në 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.**
- **Permasat e Veshjeve, Dorezave dhe e Çizmeve do të përcaktohen në momentin e lidhjes së Kontratës.**

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
-

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes ne SPE **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.
3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklaratë perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim 2.1:Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrsesit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

3.Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
Etj.,			

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesi certifikate të origjines se mallit objekt prokurimi nepermjet te cilave te vertetoje se malli objekt prokurimi eshte konform standarteve CE.

5.OE duhet të paraqese ne SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhesei per mallrat e ofertuara.Ne rastet e autorizimit nga dristibutori, duhet të vertetohet lidhja qe distributori ka me prodhuesin.Ne autorizim duhet të jete i paraqitur Nr i references se proçedures se prokurimit si dhe te dhena te sakta te Prodhuesit/Dristibutirit ne menyre qe AK te kete mundesi te kryej verifikimet e nevojshme

6.Operatori Ekonomik duhet të paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar per çdo produkt sipas kerkesave te AK si dhe realizimin e kontrates sipas afatit 20 ditor.

7.Operatori ekonomik ofertues të paraqese certifikatat qe vërteton se sistemi I kontrollit të cilësisë së ofertuesit është sipas standartit.

- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikate personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet të jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Xhup 3/1 : SSH/ EN 342; SSH /EN ISO 20471 klasi 2. SSH/ EN 343 klasi 3,SSH/ISO 13688.**ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Çizme Llastiku :SSH/EN ISO 20347:2012,** ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Kepuce sigurie: SSH/ EN ISO 20345 S3,** ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Kominoshe dimri: SSH EN ISO 20471 klasi 2. SSH/ EN 343 klasi 3:2** ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Kominoshe vere: SSH /EN ISO 20471 klasi 2** ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Pantallona+xhakete: SSH /EN ISO 20471 klasi 2** ose ekuivalente.
- OE duhet të paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Jelek fosforeshent: SSH/ EN 340** ose ekuivalente.

- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Doreza sigurie**; SSH /EN420: 2003 + A1: 2009 Kërkesa të përgjithshme ,SSH /EN388: 2016 Doreza mbrojtëse ndaj rreziqeve mekanike (Nivelet e marra në pëllëmbë) ose ekuivalente
Te cilat perputhen me Rregulloren e BE 2016/425, me kërkesat e saj dhe me standardet e harmonizuara si dhe Rregulloren (BE) 2016/425
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Doreza pune**: SSH EN 420. SSH /EN 388. 2003ose ekuivalente.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Pelerine Shiu**: SSH/ EN ISO 343:2019 CLASS 3.1ose ekuivalente.

8.Operatori ekonomik ofertues, ne ditën e hapjes se ofertave (perpara hapjes se tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, prane NSHK Durres , duhet të paraqesë të protokolluara nje moster për secilin ze te mallrave objekt prokurimi, sipas listes se kerkuar:

Tabela:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia	Sasia
1	Xhup 3/1	Cope	1
2	Çizma Llastiku	Cope	1
3	Kepuce sigurie	Pale	1
4	Kominoshe dimri	cope	1
5	Kominoshe vere	cope	1
6	Pantallona+Xhaket	Pale	1
7	Jelek fosforeshent	Cope	1
8	Doreza sigurie	Cope	1
9	Doreza pune	Cope	1
10	Pelerine shiu	Cope	1
11	Kapele verore	Cope	1

- Mostrat e dorezuara nga OE do te dorzohen sipas specifikimeve si dhe te shoqerohen me Skeden teknike dhe Çertifikatë konformiteti SSH ose EN cilësie CE/ekuivalent
Shenim: Per zarin 11 ne tabele nuk eshte e nevojshme te paraqitet Skeden teknike dhe Çertifikatë konformiteti SSH ose EN cilësie CE/ekuivalent

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar	• nformacioni mbi subjektet mbi

kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit</p>

ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specififikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

